

# NJOFTIM PËR KËSHILLIM PUBLIK

MBI

DHËNIEN NË PËRDORIM TË BREZAVE TË FREKUENCAVE

IMT

1900-1980 dhe 2110-2170 MHz

## 1. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare - AKEP,

a) Bazuar në:

- pikën 2 dhe 4 të nenit 5, shkronja g) dhe gj) të nenit 8, pika 2 e nenit 65, neni 66 dhe neni 68 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918), i ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”,
- shkresa e Ministrit nr. 207/1Prot. datë 14.2.2014, si përgjigje e propozimit të AKEP;
- Vendimin e KD të AKEP nr.2424, datë 27.02.2014 për “Miratimin e kryerjes së procesit të këshillimit publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz (IMT)”

b) Me qëllim:

- **përmbushjen me sukses të politikës së zhvillimit të sektorit të komunikimeve elektronike,**
- nxitjen e një konkurrence sa më eficiente në tregun e komunikimeve elektronike dhe përdorimit sa më të frytshëm të frekuencave në rastet e kufizimit të tyre **si dhe**
- në plotësim të kërkesave të sipërmarrësve për frekuenca,

nis këshillimin publik për dhënie të drejtash përdorimi në brezat e frekuencave **1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz (IMT).**

## 2. Synimi i AKEP është:

Zbatimi i një procesi dhënie të drejtash përdorimi sa me objektiv dhe transparent në përfitim të konsumatoreve shqiptare dhe ekonomise shqiptare, krijimin e një tregu konkurrues në Shqipëri, si dhe përdorimit efektiv të spektrit.

### 3. Burimet e spektrit:

Plani Kombëtar i Radio Frekuencave përcakton brezat 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz ku mund të autorizohen shërbimet IMT.

Të drejtat e përdorimit janë parashikuar të jepen në brezin e frekuencave 1965-1980 MHz - çiftuar me 2155-2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915-1920 MHz.

### 4. Kushtet e përdorimit:

Në Planin Kombëtar të Frekuencave (dhe brenda CEPT) ky brez është përcaktuar si përdorim kryesor për IMT. Kjo përfshin IMT-2000 dhe IMT - të avancuar. Përdorimi i këtij brezi do të bëhet në përputhje me vendimin e "Electronic Communications Committee"- ECC/DEC/ (06)01 - "The harmonised utilisation of the bands 1920-1980 MHz and 2110-2170 MHz for mobile/fixed communications networks (MFCN) including terrestrial IMT systems", rekomandimin ERC/REC (01)01 dhe standartin ETSI - EN 301 908.

5. Bazuar në sasinë e spektrit (2x15 MHz spektër i çiftuar 1965-1980 MHz - çiftuar me 2155-2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915-1920 MHz), AKEP propozon mundësinë e dhënies së më shumë se një të drejtë përdorimi me ndarje brezi si në tabelën e mëposhtme:

<b>Të drejtat e përdorimit</b>	<b>Sasia e spektrit</b>
<b>A</b>	<b>2x5 MHz spektër i çiftuar, 1965 -1970 MHz çiftuar me 2155-2160 MHz</b>
<b>B</b>	<b>2x5 MHz spektër i çiftuar 1970-1975 MHz çiftuar me 2160-2165 MHz</b>
<b>C</b>	<b>2x5 MHz spektër i çiftuar 1975-1980 MHz çiftuar me 2165-2170 MHz</b>
<b>D</b>	<b>5 MHz spektër i paçiftuar 1915-1920 MHz</b>

- Pyetja 1: A jeni dakort me këtë ndarje të propozuar nga AKEP?*
- Pyetja 2: Bazuar ne këtë ndarje cila është vlera që jeni gati të paguani për të drejtë përdorimi? Komentet përkatëse.*
- Pyetja 3: Në se do të rezultoni fitues i një të drejtë përdorimi cili do të jetë qëllimi i përdorimit të tij? Komentet përkatëse.*
- Pyetja 4: Në se do të rezultoni fitues i një të drejtë përdorimi, cila është teknologjia që do të aplikoni për ndërtimin e rrejtit të aksesit? Komentet përkatëse.*

*Argumentat në se keni ndonjë çështje tjetër për tu marrë në konsideratë.*